Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike	
Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.	
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës	
Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial	
Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit	
Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike	
Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit	
Shtojca 8: Termat e Referencës	
Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve	
Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	
Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit	
Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit	
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit	
Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rast]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimet teknike janë hartuar për të përcaktuar kërkesat teknike, standardet e cilësisë, mënyrën e realizimit të punimeve dhe detyrimet e kontraktorit për zbatimin e objektit "Mirëmbajtja e godinave publike". Punimet do të realizohen në përputhje me projektin, preventivin, relacionin teknik, Kushtet Teknike të Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit (KTZ), standardet shqiptare (STASH), standardet evropiane (EN), Eurokodet kur janë të zbatueshme, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për ndërtimin, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kontraktori është përgjegjës për realizimin e plotë të të gjitha punimeve sipas dokumentacionit teknik, duke garantuar cilësi të lartë të zbatimit, përdorimin e materialeve të certifikuara dhe respektimin e praktikave më të mira inxhinierike. Çdo devijim nga dokumentacioni teknik mund të kryhet vetëm pas miratimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktor dhe Mbikëqyrësi i Punimeve. Përpara fillimit të punimeve kontraktori do të marrë në dorëzim ambientet ku do të kryhen ndërhyrjet dhe do të organizojë kantierin në mënyrë që të garantohet zhvillimi normal i aktivitetit në godinat publike. Zona e punimeve duhet të rrethohet dhe të pajiset me sinjalistikë paralajmëruese, ndërsa hyrjet dhe daljet e mjeteve duhet të organizohen në mënyrë që të mos krijojnë rrezik për qytetarët dhe punonjësit.

Në rastet kur ndërhyrjet zhvillohen në objekte administrative ose institucione arsimore, punimet duhet të planifikohen në mënyrë që të minimizojnë ndikimin në aktivitetin e përditshëm.

Kontraktori është përgjegjës për ruajtjen e pastërtisë së kantierit, sistemimin e materialeve, sigurimin e mjeteve kundër zjarrit dhe pajisjeve të ndihmës së parë, si dhe për mbrojtjen e elementeve ekzistuese që nuk janë pjesë e ndërhyrjes.

Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës kontraktori duhet të zbatojë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë. Ai duhet të kufizojë pluhurin, zhurmat dhe ndotjen e mjedisit, të largojë rregullisht mbetjet ndërtimore në vendet e miratuara dhe të mbajë të pastër zonën e punimeve.

Personeli duhet të jetë i pajisur me helmeta, jelekë reflektues, këpucë sigurie, doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse sipas natyrës së punës. Punimet në lartësi duhet të kryhen me mjete të sigurta dhe duke respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kontraktori mban përgjegjësi për çdo incident që mund të ndodhë gjatë zbatimit të punimeve.

Të gjitha materialet që do të përdoren duhet të jenë të reja, të papërdorura, të certifikuar dhe të shoqëruara me dokumentacionin teknik përkatës. Nuk do të pranohen materiale të dëmtuara, materiale jashtë afatit të përdorimit apo materiale që nuk përmbushin standardet teknike dhe kërkesat e projektit.

Për çdo material kryesor kontraktori duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë dhe deklaratat e konformitetit. Autoriteti Kontraktor dhe Mbikëqyrësi kanë të drejtë të kërkojnë analiza laboratorike ose prova shtesë për materialet që paraqesin dyshime mbi cilësinë e tyre.

Punimet e prishjes përfshijnë heqjen e elementeve të amortizuara, suvatimeve të dëmtuara, shtresave ekzistuese të dyshemeve, pllakave, tavaneve të dëmtuara, kartonxhesit, shtresave të betonit dhe elementeve të tjera të parashikuara në preventiv.

Prishjet duhet të realizohen me kujdes, duke shmangur dëmtimin e pjesëve të objektit që nuk janë pjesë e ndërhyrjes. Materialet e dala nga prishja do të grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vendet e autorizuara për depozitimin e mbetjeve. Pas përfundimit të prishjeve sipërfaqet duhet të pastrohen plotësisht dhe të jenë të gatshme për punimet pasuese.

Punimet ndërtimore përfshijnë realizimin e muraturave prej guri, mureve me kartonxhes rezistent ndaj lagështisë, punimeve me beton dhe betonarme, konstruksioneve metalike dhe shtresave të betonit me rrjetë çeliku. Të gjitha këto punime duhet të realizohen sipas projektit dhe preventivit, duke respektuar kërkesat teknike për rezistencën, qëndrueshmërinë dhe cilësinë. Muraturat duhet të realizohen me materiale cilësore dhe fuga të mbushura plotësisht. Punimet me kartonxhes duhet të kryhen me profile metalike të galvanizuara dhe pllaka rezistente ndaj lagështisë. Punimet e betonit duhet të realizohen me klasën e betonit të përcaktuar në projekt, duke garantuar vibrimin, kurimin dhe mbrojtjen e tij deri në arritjen e rezistencës së kërkuar.

Konstruksionet metalike duhet të prodhohen nga çelik cilësor, të mbrohen kundër korrozionit dhe të montohen sipas projektit teknik.

Në ambientet ku është parashikuar do të realizohen shtresa rere natyrore, shtresa betoni, parket laminat dhe shtrim me pllaka gres porcelanato. Bazamenti duhet të jetë i pastër, i rrafshët dhe i ngjeshur përpara fillimit të punimeve.

Parketi laminat duhet të jetë rezistent ndaj konsumit dhe lagështirës dhe të montohet me sistem "Click". Pllakat gres porcelanato duhet të jenë të klasës së parë dhe të vendosen me kolë cilësore, duke garantuar fuga uniforme dhe sipërfaqe të niveluar. Nuk lejohen pllaka të krisura ose boshllëqe nën sipërfaqe.

Punimet e suvatimit do të realizohen mbi sipërfaqe të pastruara dhe të përgatitura sipas kërkesave teknike. Përpara aplikimit të suvasë do të kryhet pastrimi i sipërfaqeve, sistemimi i parregullsive dhe sprucimi për përmirësimin e aderencës.

Suva duhet të ketë trashësi uniforme, sipërfaqe të rrafshët dhe rezistencë të lartë mekanike. Nuk lejohen çarje, fryrje, zgavra ose shkëputje të shtresës së suvasë. Pas suvatimit do të realizohet patinimi me stuko cilësore deri në krijimin e një sipërfaqeje të lëmuar dhe të gatshme për bojatisje.

Bojatisja do të realizohet vetëm pasi sipërfaqet të jenë tharë plotësisht dhe të jenë përgatitur sipas kërkesave teknike. Përpara aplikimit të bojës do të vendoset astari, ndërsa elementët që nuk lyhen do të mbrohen.

Do të përdoret bojë hidroplastike e cilësisë së parë, rezistente ndaj konsumit dhe larjes. Lyerja do të realizohet në dy ose më shumë shtresa, duke respektuar kohën e tharjes ndërmjet tyre. Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë uniforme, pa njolla, pa rrjedhje dhe me mbulim të plotë. Punimet përfshijnë furnizimin dhe montimin e dritareve me profile alumini dhe dopio xham, si dhe vendosjen e dyerve të reja të brendshme sipas preventivit. Dritaret duhet të jenë hermetike, funksionale dhe të garantonin izolim termik dhe akustik. Dyert duhet të pajisen me të gjithë aksesoret përkatës dhe të funksionojnë normalisht pas montimit.

Në rastet kur parashikohet restaurimi i dyerve ekzistuese, do të kryhet pastrimi, lëmimi, riparimi i defekteve dhe lyerja me llak deri në arritjen e një përfundimi cilësor.

Kontraktori është përgjegjës për kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së materialeve dhe punimeve. Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë të kontrollojë çdo fazë të zbatimit, të kërkojë dokumentacionin teknik dhe të refuzojë materiale ose punime që nuk përmbushin kërkesat e projektit dhe specifikimeve teknike.

Kur është e nevojshme mund të kërkojnë analiza laboratorike për betonin, armaturën, materialet e veshjes ose materiale të tjera. Çdo punim me defekte do të riparohet ose do të zëvendësohet me shpenzimet e kontraktorit.

Matja e punimeve do të kryhet sipas njësive të preventivit dhe vetëm për punimet e realizuara në përputhje me projektin dhe të miratuara nga Mbikëqyrësi i Punimeve. Punimet do të konsiderohen të përfunduara vetëm pas kontrollit teknik, eliminimit të mangësive, pastrimit të objektit dhe dorëzimit të dokumentacionit teknik.

Kontraktori mbetet përgjegjës për çdo defekt që mund të konstatohet gjatë periudhës së garancisë dhe është i detyruar të ndërhyjë menjëherë për riparimin e tyre pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Qëllimi i këtyre specifikimeve teknike është garantimi i realizimit të punimeve të mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta profesionale, duke siguruar funksionalitetin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e godinave publike të Bashkisë Himarë. Të gjitha ndërhyrjet do të realizohen në përputhje me dokumentacionin teknik, preventivin dhe legjislacionin në fuqi, duke respektuar kërkesat për cilësi, siguri dhe mbrojtje të mjedisit. Pas përfundimit të punimeve, objekti duhet të dorëzohet në gjendje të pastër, funksionale dhe plotësisht të gatshme për përdorim, së bashku me të gjithë dokumentacionin teknik, certifikatat e materialeve dhe procesverbalet përkatëse të kontrollit dhe pranimit të punimeve. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë verifikime në çdo fazë të zbatimit të kontratës për të garantuar respektimin e plotë të specifikimeve teknike dhe cilësinë e investimit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr	Analizë	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia
1	2.426/9	Prishje suvatim i jashtëm	m ²	60
2	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshëm	m ²	80
3	2.426/12	Prishje suvatim solete (h<4m)	m ²	30
4	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	60
5	3.182/a	Shtresë rërë natyrore t=10cm	m ²	25
6	3.632	Heqje pllaka trotuari	copë	25
7	2.276/a	Shtresë parketi laminat	m ²	45
8	2.54/2	Mur guri në lartësi deri 3m me llaç çimento M 25	m ³	3
9	2.109	Heqje muri me kartonxhes	m ²	80
10	2.108/1c	Ndërtim muri me gips t=10cm me dy shtresa kundër lagështirës	m ²	30
11	2.130	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20	m ³	3
12	2.182	F.V. Konstrukione metalike të thjeshta.	ton	0.60
13	2.700	Shtresë betoni C 12/15 me zgarë hekuri	m ³	9
14	2.267b	Shtresë me pllaka grez importi, 40x40cm	m ²	25
15	2.588	Heqje shtrese betoni ekzistues në taracë	m ³	45
16	2.281	Heqje pllaka dyshemeje	m ²	12
17	2.300	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m ²	25
18	2.312	Suva brenda mur guri ~ 4m, me krah, llaç përzier M25	m ²	15
19	2.332	Suva e zakonshme fasade mur guri ~ 8m	m ²	50
20	2.334	Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartësi	m ²	12
21	2.335	Suva e zakonshme fasade mur guri mbi 8m lartësi	m ²	12
22	2.297/a	Veshje tavani me kartonxhes	m ²	50
23	2.330/1	Patinim tavani me stuko	m ²	80
24	2.328/1	Patinim muri me stuko	m ²	122
25	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m ²	4
26	2.388/1	F.V. Dyer të brendeshme tamburate të rimesuara	m ²	12
27	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m ²	4
28	2.694	Pastrim dhe lyerje derë me llak	m ²	12
29	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gëlqere	m ²	255.70
30	2.404/1	Boje hidroplastike cilësi e lartë	m ²	1 720
31	3.837/a	Rrethim rruge me rrjetë teli	m ²	80

Afatet e ekzekutimit: 6 (gjashtë) muaj.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve

Qëllimi i kontratës është garantimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme, riparimit dhe rehabilitimit të godinave publike në administrim të Bashkisë Himarë, me synim ruajtjen e funksionalitetit, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe kushteve optimale të përdorimit të tyre. Shërbimet do të realizohen sipas nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kuadër dhe do të përfshijnë ndërhyrje të zakonshme dhe emergjente për eliminimin e dëmtimeve të shkaktuara nga amortizimi natyror, përdorimi i vazhdueshëm ose faktorët atmosferikë.

Punimet do të realizohen në përputhje me projektet teknike, preventivat, specifikimet teknike, Kushtet Teknike të Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit (KTZ), Standardet Shqiptare (STASH), standardet evropiane (EN), Eurokodet kur janë të zbatueshme, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për ndërtimin, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kontraktori është përgjegjës për organizimin e plotë të punimeve, sigurimin e fuqisë punëtore, mjeteve, pajisjeve, makinerive dhe materialeve të nevojshme, duke garantuar realizimin e ndërhyrjeve sipas standardeve teknike dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Detyrat

Operatori ekonomik fitues do të kryejë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për mirëmbajtjen e godinave publike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe preventivit të miratuar. Shërbimet do të përfshijnë punime prishjeje dhe largimin e materialeve të dala nga prishjet, punime murature, suvatime të brendshme dhe të jashtme, punime betoni dhe betonarme, realizimin e mureve me kartonxhes rezistent ndaj lagështirës, ndërtimin ose riparimin e konstruksioneve metalike, shtrimin e parketit laminat dhe pllakave gres porcelanato, realizimin e shtresave të betonit dhe shtresave mbështetëse, si dhe çdo ndërhyrje tjetër të parashikuar në preventiv.

Shërbimet do të përfshijnë gjithashtu patinimin dhe përgatitjen e sipërfaqeve për lyerje, bojatisjen me bojë hidroplastike cilësore, furnizimin dhe montimin e dyerve të brendshme dhe dritareve me profile alumini dhe dopio xham, restaurimin e elementeve ekzistuese kur kjo parashikohet në preventiv, si dhe sistemimin përfundimtar të ambienteve pas përfundimit të punimeve.

Kontraktori është përgjegjës për organizimin e kantierit, vendosjen e sinjalistikës së nevojshme, marrjen e masave për mbrojtjen e qytetarëve dhe punonjësve, zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtjen e mjedisit, largimin e mbetjeve ndërtimore në vendet e autorizuara dhe rikthimin e ambienteve në gjendje të pastër pas përfundimit të çdo ndërhyrjeje. Të gjitha materialet që do të përdoren duhet të jenë të reja, të papërdorura, të certifikuara dhe në përputhje me kërkesat e projektit dhe standardet teknike në fuqi. Kontraktori duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë dhe deklaratat e konformitetit për materialet kryesore, ndërsa Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë kontrollë dhe prova laboratorike për verifikimin e cilësisë së tyre.

Kontraktori është përgjegjës për cilësinë e punimeve deri në marrjen në dorëzim të tyre dhe gjatë gjithë periudhës së garancisë. Çdo mangësi ose defekt i konstatuar gjatë kontrollit teknik ose periudhës së garancisë do të riparohet me shpenzimet e operatorit ekonomik.

Shpërndarja

Shërbimet do të realizohen në të gjitha godinat publike që administrohen nga Bashkia Himarë, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Himarë. Vendet konkrete të ndërhyrjes do të përcaktohen në urdhrat e punës ose kontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve

Shërbimet do të kryhen në godinat publike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda territorit të Bashkisë Himarë. Ndërhyrjet do të realizohen sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar që aktiviteti normal i institucioneve të mos pengohet, përveç rasteve kur natyra e punimeve kërkon pezullim të përkohshëm të përdorimit të ambienteve.

Pas përfundimit të çdo ndërhyrjeje, kontraktori është i detyruar të pastrojë plotësisht ambientet, të largojë mbetjet ndërtimore, të rikthejë zonën në gjendje funksionale dhe të dorëzojë punimet të shoqëruara me dokumentacionin teknik, certifikatat e materialeve të përdorura, procesverbalet e kontrollit dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Punimet do të konsiderohen të pranuar vetëm pas verifikimit nga Mbikëqyrësi i Punimeve dhe përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor, të cilët do të konfirmojnë përputhshmërinë e tyre me projektin, preventivin, specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente: Kategoria NP-3, Klasifikimi A, Emërtimi “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile e industrial, veshje fasada”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- bojaxhi 1 (një)
- hidraulik 1 (një)
- elektrikist 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë kontratë Individuale të Punës (të vlefshme) dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi të njohur nga Republika e Shqipërisë, Institucione Shtetërore ose organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Listëpagesës sipas formularit standart për sigurimet për muajin Qershor 2026.

Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Qershor 2026.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues me vinc kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qira
Skela	500 m ²	Pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi
Motobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozitë uji >= 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qira
Kokore	10 copë	Pronësi ose me qira
Kuti e ndihmës së shpejtë	10 copë	Pronësi ose me qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:*

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- leje qarkullimi;
- certifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit.

b) *Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet:*

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;
- leje qarkullimi;
- certifikatën e kontrollit teknik,
- siguracionin e mjetit.

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Mjetet dhe pajisjet teknike e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

2.3.5 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 ose ekuivalente;*
- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 ose ekuivalente;*
- *Certifikatë për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001 ose ekuivalente;*
- *Certifikatë e sistemit të integruar të menaxhimit BS PASS 99:2012 ose ekuivalente*

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontratës së Bashkëpunimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

